

-90-

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETARE I UJIT**  
**KESHILLI BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

Adresa : Qendra Transferimit te Teknologjive Bujqesore, Kati 3.

Nr. 88/8 Prot.

Shkoder, me dt. 21.09. 2010

**INFORMACION**

**“MBI PERDORIMIN E BURIMIT UJOR LUMI PAJES**  
**FSHATI CURRAJ I EPERM**  
**PER PRODHIM TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA**  
**SUBJEKTI “TELEMENIA ALB” SH.A .**  
**HEC MARASH ”**

**Vendim i K.B.U. Drin-Bune Nr. 2 Dt. 03.09. 2010**

Bazuar ne kerkesen e pa kerkuar te bere nga Subjekti “TELEMENIA ALB” sh.a. per perdorimin e burimit uJOR Lumi Pajes, per prodhim energjie elektrike nen 15 MW, dhe se propozimi i mesiperm, sipas dokumentacionit qe disponon K.B.U. Drin-Bune nuk ka te beje me projekte per te cilat ka filluar apo eshte shpallur procedura e perzgjedhjes.

Sipas dokumentacionit te paraqitur nga subjekti i mesiperm vepra e marrjes se ujit do te ndertohet ne Lumin e Pajes , ne kuoten + 1105 m. Ndertesa e centralit do ndertohet ne kuoten + 971 m. Prurja mesatare eshte  $Q = 1.83 \text{ m}^3/\text{sek}$ . Subjektei kerkon te shfrytetoje nje prurje  $Q = 2.73 \text{ m}^3/\text{sek}$ .

Subjekti gjate gjithë viti nuk do te pengojë furnizimin me uje te zones.

Ky informacion jepet nga K.B.U. Drin-Bune, bazuar ne nenet 4, 5, 9 dhe 23 te ligjit nr. 9663 dt. 18.12.2006 “ PER KONCESIONET” dhe ne zbatim te tij te germes b, pika 3, kreu IV, i V.K.M. nr. 87 dt. 16.01.2008, “Per disa ndryshime dhe shitesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M. “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, per plotesim dokumentacioni.

**PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

**Sekretari**

**Muhamet MUCA**

**Kryetari**

**Maxhid CUNGU**

